



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KESHILLI

Nr. 2276/Prot.
13

Pogradec, më 30.05.2024

VENDIM

NR. 65, DATË 29.05.2024

PER MIRATIMIN E SISTEMIT TË PIKËZIMIT PËR PËRZGJEDHJEN E PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I STREHIMIT SOCIAL "PERMIRESIMI I KUSHTEVE TE BANIMIT PER FAMILJET E PAFAVORIZUARA".

Ne mbështetje të Ligjit Nr. 22/2018 "PËR STREHIMIN SOCIAL" përkatësisht: Nenit 2, pika: 13,14,15,20,25,27,44,49, 51; Neni 3, pika 3 ; Neni 40,41,42,43 "PËR PERMIRESIMIN E KUSHTEVE TE BANIMIT", me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK

VENDOSI :

1. Miratimin për sistemin e pikezimit mbi projektin "*Përmirësimi i kushteve të banimit për familjet e pafavorizuara*".

SISTEMI I PIKËZIMIT PËR TRAJTIMIN SIPAS PROGRAMIT "PERMIRESIMI I KUSHTEVE TE BANIMIT PER FAMILJET E PAFAVORIZUARA"		
NR.	KRITERET E PIKËZIMIT	PIKËT
A	KUSHTET E STREHIMIT	25
i	Nuk disponojnë banesë në pronësi	6
ii	Kanë ngelur të pastrehë si rezultat i fatkeqësive natyrore ose zbatimit të një vendimi gjyqësor.	5
iii	Banesa në rrezik shembje sipas përcaktimeve ligjore dhe rrezikojnë të ngelen të pastrehë.	5
iv	Banojnë në banesa të mbipopulluara sipas përcaktimeve dhe normave në fuqi.	4
v	Banojnë në banesa që prishen ose përjashtohen nga procesi i legalizimit si rezultat i investimeve publike.	5
B	KUSHTET FAMILJARE	25
i	Familjet njëprindërore që kanë në ngarkim fëmijë,ku përfshihen edhe vajzat nëna.	5
ii	Të moshuarit, që kanë mbushur moshën e pensionit dhe që nuk përzgjidhen për t'u strehuar në institucionet publike të përkujdesjes shoqërore.	0
iii	Familjet me më shumë se 4 (katër) fëmijë.	5
iv	Familjet e reja, ku mosha e anëtarit më të madh të familjes në momentin e kërkesës të jetë më e vogël ose baraz me 40 vjeç.	8



v	Të rinj, që në momentin e aplikimit kanë moshë jo më të madhe se 40 vjeç.	7
C	KUSHTET SOCIALE	25
i	Personat me aftësi të kufizuara, në përputhje me përcaktimet e bëra me vendim të Këshillit të Ministrave për këto kategori dhe me shërbime kujdestarie.	4
ii	Individë më statusin e jetimit, që nga çasti i daljes nga qendrat e përkujdesjes shoqërore e deri në moshën 30 vjeç.	2
iii	Familjet e mbetura të pastreha për shkak të lirimit të banesave ish-pronarëve.	0
iv	Emigrantë të rikthyer, punëtorët emigrantë dhe azilkërkuesit, refugjatët apo personat me mbrojtje plotësuese.	2
v	Familjet e policëve të rënë në detyrë.	0
vi,	Punonjës i reparteve të ndërhyrjes së shpejtë FNSH	3
vii,	Punonjësit e repartit RENE A	
viii	Punonjësit e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit	
ix	Viktimat e trafikimit / Viktimat e mundshme të trafikimit	3
x	Anëtarët e komunitetit Rom dhe Egjiptian	4
xi	Të miturit në konflikt me ligjin, sipas parashikimeve të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, pas ekzekutimit të dënimit.	2
xii	Vajzat Nëna.	3
xiii	Individët që i përkasin komuniteti LGBTI, të cilët janë viktime për shkak të orientimit seksual ose identitetit gjinor	2
D	KUSHTET EKONOMIKE	25
i	Të ardhurat nën 70% të të ardhurave mesatare të njësisë të vetqeverisjes vendore.	7
ii	Të ardhura 70-100% të të ardhurave mesatare të njësisë të vetqeverisjes vendore.	9
iii	Të ardhura 100-120% të të ardhurave mesatare të njësisë të vetqeverisjes vendore.	9
	TOTALI PIKË	100

KRYETARE E KËSHILLIT

Manjola KAMOLLI



1. Miratuar me 23 vota

2. Vota Pro 23

3. Vota Kundër 0

4. Vota Abstenim 2

5. Zbardhur më datë 30.05.2024